



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Komisioni për të Drejta dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, 24.5.2016 , filloi në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, kryetare, Agim Qeku, nënkryetar i parë, Mufera Shinik, nënkryetar i dytë, Sasha Milosavljeviq, Slavko Simiq, Milka Vuletiq, Agim Kukaj, Qerim Bajrami, Veton Berisha i Danush Ademi, anëtarë.

Munguan: Rustem Berisha dhe Fisnik Ismajli, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë në mbledhje: vëzhgues të OSBE-së dhe Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Zhivković, kryetare e komisionit

Në mbledhje u propozua ky rend i ditës:

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-050 për Kinematografinë me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L- 77 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**

4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L- 78 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L 096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
6. **Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa vërejtje dhe hapi për shqyrtim pikën e dytë të renditë ditës

2. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-050 për Kinematografinë me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Meqë nuk kishte vërejtje as diskutime për Projektligjin me raportin e Komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interkomanesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin Nr. 05/L-050 për Kinematografinë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit Kryetarja e hapi për shqyrtim pikën e katërtë të rendit të ditës
3. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L- 77 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**

Meqë nuk kishte vërejtje as diskutime për Projektligjin me raportin e Komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin Nr. 05/L- 77 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit Kryetarja e hapi për shqyrtim pikën e katërtë të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L- 78 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Meqë nuk kishte vërejtje as diskutime për Projektligjin me raportin e Komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin Nr. 05/L- 78 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit Kryetarja e hapi për shqyrtim pikën e katërtë të rendit të ditës

Kryetarja e hap për shqyrtim pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L 096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa

Meqë nuk kishte vërejtje as diskutime për Projektligjin me raportin e Komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin Nr. 05/L 096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit Kryetarja e hapi për shqyrtim pikën e katërtë të rendit të ditës

6. Të ndryshme

Kryetarja, i informoi anëtarët se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur në rend të ditës e ka vënë për shqyrtim të dytë Projektligjin nr. 05/L-10 për Agjencionit Kosovar për krahasimin dhe verifikimin e pronave me amendamentet e Komisionit funksional për legjislacion, mandat, imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër korrupsion pa raportin e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

Përveç kësaj Komisioni funksional është ftuar nga ana e Kuvendit që ta analizojë këtë Ligj qysh në muajin prill të vitit 2015, ndërsa Komisionit tonë i shihet për të madhe pse nuk e ka proceduar të njëjtin me procedurë të rregullt por tani kërkon vazhdimin e afatit për ta shqyrtuar. Kjo është e pa pranueshme për shumë arsye e njëra ndër to është se ky Projektligj i përket të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe marrëdhënieve pronësore juridike dhe në masë të madhe i referohet komunitetit. Si përfaqësuese e komunitetit serb do të dalë para Kuvendit dhe do të kërkojë afat shtesë për shqyrtimin e këtij ligji, sepse i njëjti i cenon interesat e komuniteteve.

Qerim Bajrami - propozoi që në pajtim me planin e punës së Komisionit në mbledhjen e ardhshme të ftohet ministri Dalibor Jeqiq dhe të raportojë për temën mbikëqyrja buxhetore e të hyrave në Ministri për tremujorin e dytë të vitit 2016.

Mbledhja përfundoi në 12:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja i Komisionit

Jasmina Zhivković